

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Sot me datën 28. 09.2021 (dymijë e njëzete e një), lidhet kjo Kontratë Shitblerje Kuote (në vijim referuar si "Kontrata"), ndërmjet palëve si vijon:

**SHITËSIT:** **Anisa Omari**, e bija e Llazarit, lindur me 27.06.1986, ne Fier dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit me nr. Personal I65627101H.  
(në vijim referuar si "Shitësi")



**BLERËSI:** **Ardit Kane**, i biri Harilles, lindur me 22.10.1985, ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit me nr. Personal I51022054I.  
(në vijim referuar si "Blerësi")

Këtu e në vijim Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si "Palë" dhe së bashku si "Palët".

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht në **nenet 710 e vijues te Kodit Civil, nenet 72, 73 dhe 74 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe në nenin 7 të Statutit të Shoqërisë, palët dakordësuan këtë Kontratë me përmbajtje si më poshtë vijon:**

### **MEQENËSE:**

1. Shoqëria "**Lead Consulting**" sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar ne regjistrin tregtar, te mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi të Subjekti (NUIS): L82322016N, me seli ne adresën: *Rruga Njësia Nr. 5, Rruga Sami Frashëri, Pallati 8, Hyrja 9* (në vijim referuar si "**Shoqëria**")
2. Bazuar në Ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është 1.000,00 (një mijë) lekë dhe është i ndarë si vijon:
  - a. **Ardit Kane**, zotërues i një kuote me vlerë nominale 150,00 (njëqinde e pesedhjetë) Lekë, qe i korrespondojnë 15 (pesëmbëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë;
  - b. **Anisa Omari**, zotërues i një kuote me vlerë nominale 850,00 (tetëqind e pesedhjetë) Lekë, qe i korrespondojnë 85 (tetedhjetë e pese) % të kapitalit të Shoqërisë;



3. Shitësi siç përshkruhet edhe me sipër, është ortak i Shoqërisë dhe zotërues i një kuote me vlerë nominale 850,00 (tetëqind e pesedhjetë) Lekë, qe i korrespondojnë 85 (*tetedhejte e pese*) % të kapitalit të Shoqërisë.
4. Blerësi nga ana tjetër shprehet se dëshiron të bëhet pronar i kuotës qe Shitësi zotëron tek Shoqëria dhe rrjedhimisht Ortak i Vetëm i Shoqërisë.

**PËR KËTË ARSYE**, në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

## NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Transferimi me anë të shitblerjes, i kuotës që Shitësi zotëron tek Shoqëria me vlerë nominale 850,00 (tetëqind e pesedhjetë) Lekë, që i korrespondojnë 85 (*tetedhejte e pese*) % të kapitalit që Shitësi zotëron në Shoqëri, ndaj ortakut tjetër z. Ardit Kane.

## NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E LIKUIDIMIT

- 2.1 Me vullnet të përbashkët të palëve caktohet se çmimi i shitjes së kuotës të përshkruar në nenin 1 të kësaj Kontrate do të jetë 850,00 (tetëqind e pesedhjetë) Lekë.
- 2.2 Çmimi i Shitjes do të likuidohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Megjithatë Çmimi i Shitjes duhet likuiduar brenda 30 (*tridhjetë*) ditëve nga data e nënshkrimit të saj.

## NENI 3 DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESIT



### 3.1 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

#### (a) *Pronar i Ligjshëm*

Shitësi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i kuotës se zotëruar prej tij në Shoqëri identifikuar në dokumentet bashkëngjitur dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontrate, dhe për të përmbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj.

#### (b) *Barrët mbi Pronën*

Shitësi deklaron, kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri, objekt i kësaj Kontrate nuk është e ngarkuar me asnjë barrë, qoftë si peng, barrë siguroese apo barrë financiare (qofshin këto ligjore, gjyqësore apo kontraktore), apo të drejta të tjera të ngjashme me to, çdo e drejtë apo interes i dhënë me kontrate çdo



personi, duke përfshirë çdo të drejte blerje, opsioni ose të drejte parablerje, dhënie përdorimi apo posedimi me kontrata të tjera, si dhe pa u kufizuar në to, çdo transaksion, veprim juridik a kufizim ligjor tjetër, përfshi këtu çdo vendim gjyqësor, përfundimtar apo të ndërmjetëm, vendim përmbarimor, apo të autoriteteve të tjera përcaktuar me ligj, i tillë që do të cenonte titullin e pronësisë së Blerësit mbi kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate.

*(c) Garancia*

Në bazë të njohurive më të mira të Shitësit, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ekzistojnë pretendime nga të tretët, çështje gjyqësore në gjykim, të pezulluara ose të mundshme, pretendime ose vendime gjyqësore a masa sigurimi ne lidhje me kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate dhe asnjëra prej këtyre padive, proceseve gjyqësore, masave dhe pretendimeve nuk ka të ngjarë të ndodhë; Të gjitha deklaratimet dhe garancitë e Shitësit të paraqitura me sipër janë të vërteta dhe të sakta.

#### **NENI 4**

##### **EFEKTE LIGJORE**

- 7.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe likuidimin e çmimit të blerjes, Blerësi bëhet pronar me të drejta të plota të kuotës së blerë, sipas përcaktimit të Objektivit të kësaj Kontrate, si më sipër, dhe Shitësi zhvishet nga çdo e drejtë lidhur me këtë kuotë.
- 7.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:
- Zj. Anisa Omari, largohet nga Shoqëria;
  - Z.Ardit Kane, bëhet Ortak i vetëm i Shoqërisë, konkretisht i kuotes me vlerë nominale 1.000,00 (*një mijë*) Lekë, që korrespondon në 100 (*njëqind*) % të kapitalit të Shoqërisë.
- 7.3 Blerësi merr përsipër, që do të kryejë të gjitha veprimet përkatëse për të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") këtë Kontrate dhe ndryshimet përkatëse në kuotat e Shoqërisë sipas pikës 2 të këtij Neni të Kontratës.


#### **NENI 5**

##### **LIGJI I ZBATUESHEM**

- 8.1 Kjo Kontrate hartohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe vlefshmëria dhe realizimi i saj do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 8.2 Për sa nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur në këtë Kontrate, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Shqiptar.

#### **NENI 6**

##### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**



9.1 Çdo lloj mosmarreveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirekuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e kësaj mosmarreveshjeje do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## NENI 7

### DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Kjo kontratë është përgatitur në Shqip, në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.


Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Palët pasi lexuan Kontratën bien dakord me sa është përcaktuar më sipër dhe konfirmojnë se ajo është përpiluar në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të pa vesuar.

#### SHITËSI

Anisa Omari

Anisa Omari



#### BLERËSI

Ardit Kane

